REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

JANAR - JANUARY
2006

TIRANE

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

Raporti Mujor

Janar 2006

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…… …….13
   d. SEKTORI MONETAR……...……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Janar 2006, arriti ne 109.7 perqind, duke shenuar nje rritje mujore prej 0.2 përqind, pas rritjes prej 2.2 dhe 0.2 perqind, perkatesisht ne muajt dhjetor_05 dhe nentor_05. Norma vjetore e inflacionit, per muajin Janar ishte 1.4 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankese se Shqiperise, prej 2 – 4 perqind.



- **Kursi mesatar i kembimit** te monedhes vendase me dy monedhat kryesore te huaja, per muajin Janar 2006, ishte:

  - 102.05 leke per dollare
  - 123.78 leke per euro



Ne muajin Janar, monedha vendese, rezultoi me nje nencmim kundrejt monedhes europiane, Euros dhe me nje mbicmim kundrejt dollarit amerikan. Sjellja e monedhes sone ne tregun vendas eshte reflektimi i sjelljes se dy monedhave ne tregjet

nderkombetare monetare si dhe i nderhyrjeve ne treg nga ana e Bankes se Shqiperise per te ruajtur nje kurs te qendrueshem.

- Gjate muajit Janar 2006, **normat e interesit te depozitave** 12-mujore ne leke, kane pesuar nje renie ne vlere absolute prej 0.07 perqind krahasuar me muajin Dhjetor 2005, ku normat e interesit ishin 5.57 perqind. Ne muajin janar 2006 normat e interesit te depozitave 12-mujore ne leke arriten kuoten e 5.5 perqind.

Rritje te lehte per kete muaj kane pesuar depozitat me afat 6-mujor, te krahasuara me nje muaj me pare (Dhjetor '05) me 0.18 perqind dhe normat me afat 3-mujor me 0.26 perqind. Renie prej 0.19 perqind kane pesuar normat per depozitat me afat 24-mujor, te cilat arriten nivelin e 6.63 perqind.

Krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare, renien me te larte vjetore e kane patur normat e interesit te depozitave 12-mujore dhe 6-mujore, respektivisht me rreth 0.31 perqind dhe 0.41 perqind,.



	Jan '05	Shku '05	Mars '05	Prill '05	Maj '05	Qersh '05	Korr '05	Gusht '05	Shtat '05	Tet '05	Nent '05	Dhje '05	Jan '06
12-M	5.81	5.72	5.44	5.22	4.87	3.89	4.06	4.42	5.28	5.32	5.45	5.57	5.50
6-M	5.36	5.18	4.85	4.70	4.41	3.77	3.72	3.90	4.55	4.75	4.89	4.77	4.95
3-M	4.49	4.36	4.16	3.95	3.65	3.08	3.02	3.13	3.87	4.11	4.17	4.07	4.33

Depozitat ne valute (euro dhe usd) kane pasur tendenca rritje per muajin Janar, duke ndjekur keshtu nje trend rrites. Rritje te ndjeshme kane pesuar interesat nominale te depozitave ne Euro dhe ne Usd. Rritja e normave te interesit ne valute erdhen si pasoje e rritjes se normave reale te lekut, duke cuar ne kete menyre ne rritje te diferences se interesave midis lekut dhe valutes

❖ Situata buxhetore

Ne fund te muajit Janar 2006, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth +5.56 miliarde leke, ose rreth -15.18 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2006.
2. **Te ardhurat gjithsej** arriten ne rreth 16.751 miliarde leke ose rreth 7.55 perqind e programit vjetor 2006.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 11.19 miliarde leke, ose rreth 4.33 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2006.



❖ **Deficiti i pergjithshem** arriti ne +5.56 miliarde leke nga 4.42 miliarde leke te parashikuar per kete periudhe 1-mujore, duke tejkaluar kufijte e parashikuar.

❖ **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 7.55 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

- Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 7.6 përqind të programimit vjetor;
- Kontributet për sigurimet shoqërore prej 8.92 përqind;
- Të ardhurat jo-tatimore 8.70 përqind e buxhetit vjetor; dhe
- Të ardhurat nga pushteti lokal, 5.96 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 4.33 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 11.078 miliardë lekë ose rreth 5.4 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 7.3 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet sociale me rreth 7.08 përqind e buxhetit vjetor dhe i shpenzimeve operative dhe te mirembajtjes me rreth 1.26perqind e buxhetit vjetor.

❖ Bilanci i pagesave

Bilanci i pagesave per tremujorin e kater 2005, rezultoi me nje sufiçit te pergjithshem prej 95.2 milion dollare. Kjo ishte rezultat i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej rreth 274.8 milion dollare;
- suficiti te Llogarise se Kapitalit, prej rreth 28.6 milion dollare;
- sufiçiti te Llogarise Financiare, prej rreth 228.6 milion dollare;
- bilanci pozitiv ne "Gabime dhe harresa neto" prej rreth 112.8 milion dollare.

Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 274.8 milion dollare ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 539.9 milion dollare;
- defiçit prej 83.3 milion dollare ne bilancin e sherbimeve;
- suficit prej 45.7 milion dollare ne bilancin e te ardhurave;
- suficit prej 302.7 milion dollare ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.

Në baze kumulative, bilanci i pagesave per vitin 2005, rezultoi me sufiçit të përgjithshëm, prej 151.4 milionë dollare.
Komponentët kyç ishin:

- defiçiti prej 557.3 milionë dollare, në llogarinë korrente,
- sufiçiti prej 123.8 milionë dollare ne llogarine kapitale,
- suficiti prej 385.6 milionë dollare në llogarinë financiare,
- bilanc pozitiv i gabimeve dhe harresave neto prej 189.3 milionë dollare.

- **Oferta totale e parase,** e matur nga M3 arriti në 581 miliardë lekë në fund të muajit Janar, duke shenuar një rritje prje 13 perqind krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.



Kjo rritje vjetore, erdhi si pasoje e rritjes se **depozitave pa afat** ne leke me rreth 112 perqind, depozitave ne valute me rreth 27 perqind, uljes se depozitave me afat ne leke me rreth 8 perqind dhe rritjes te parase jashte sistemit me rreth 7 perqind.



Ndikimin kryesor ne rritjen e ofertes monetare gjate muajit Janar e kane patur rritja e depozitave pa afat ne leke, te cilat vetem gjate ketij muaji u rriten me rreth 0.4 miliarde leke. Depozitat me afat ne leke dhe depozitat ne valute pesuan nje rritje te theksuar per kete muaj respektivisht me nga 5.7 dhe 4.2 miliard leke.

2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

a. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit, per muajin Janar '06 pesoi nje rritje prej 0.2 perqind, krahasuar me muajt Dhjetor dhe Nentor 2005, kur ky indeks ishte perkatesisht 2.2 perqind dhe 0.2 perqind. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj te nje viti me pare ishin 0.8 perqind, 3.1 perqind dhe 0.5 perqind.

Rritja prej 0.2 perqind e indeksit te çmimeve te konsumit per muajin Janar erdhi kryesisht si rezultat i rritjes se indeksit te cmimeve te grupit "Qera,uje lende djegese dhe energji" me 0.6 perqind. Rritje e cila u shkaktua si rezultat i rritjes se cmimit te qerave te banesave me 0.9 perqind.

Rritje per kete muaj pesoi edhe indeksi i cmimeve te grupit "Argetim dhe kulture" me 0.6 perqind, rritje e cila u diktua nga rritja e cmimeve te nengrupit "Gazeta, libra dhe mjete shkollore" me 0.2 perqind.

Uljen me te madhe gjate ketij muaji e pesoi grupi "Veshje dhe kepuce" ne nje mase prej – 0.6 perqind. Kjo ulje u shkaktua si rezultat i cmimve per nengrupet "Kepuce" dhe "Veshje" respektivisht me nga – 1.6 dhe – 0.5 perqind.

Norma vjetore e inflacionit ne muajin Janar arriti ne 1.4 perqind duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2005 dhe 2006 paraqiten ne tabelen e meposhtme :

	Jan	**Shku**	**Mars**	**Prill**	**Maj**	**Qer**	**Korr**	**Gusht**	**Shta**	**Tet**	**Nen**	**Dhj.**
2005	3.3	1.8	1.6	1.3	2.0	2.9	1.8	2.3	3.1	3.3	3.0	2.0
2006	1.4											

Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, ne ndryshim nga nje muaj me pare, per kete muaj shenoi nje renie prej 1.23 perqind kundrejt muajit Dhjetor 2005. Ne fund te muajit Janar, dollari amerikan arriti nivelin 102.00 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit te dollarit ne muajin Janar arriti ne 102.05 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit te lekut me Euron ne muajin Janar, arriti ne 123.78 Leke/Euro, duke shenuar nje rritje prej 1.01 perqind krahasuar me nje muaj me pare. Ne fund te muajit Janar Euro u kembye me 123.41 leke.

Gjate ketij muaji u konstatua nje nencmim i lekut kundrejt Euros dhe me nje mbicmim kundrejt Dollarit amerikan.

Ne krahasim me muajin Janar te vitit te kaluar rezulton se monedha shqiptare eshte zhvleresuar ndaj dollarit amerikan ne masen 5.4 perqind dhe eshte vleresuar kundrejt

Ndryshimet ditore te kursit te kembimit Janar '06



Vleresimi i monedhes shqiptare Lekut, kundrejt monedhes europiane Euro dhe zhvleresimi kundrejt monedhes amerikane, ne rradhe te pare eshte i lidhur me ecurine e tyre ne tregjet monetare nderkombetare, duke reflektuar sjelljen e tyre ne tregun e brendshem monetar. Kursi i kembimit te euros me dollarin amerikan pesoi nje rritje mesatare duke arritur ne rreth 1.213 dollare/euro.

Ndersa persa i perket faktoreve te brendshem ne ecurine e monedhes vendase gjate kesaj periudhe mund te permendim: flukset dalese te valutes se huaj, norma reale te interesave ne leke me te larta se normat ne valute, rritja e besimit te publikut ne sistemin financiar dhe e biznesit tek monedha vendase etj.

Interesi i huave 12-mujore gjate muajit janar pesoi nje rritje prej 1.60 perqind, duke arritur ne 13.76 perqind nga 12.16 perqind qe ishte ne muajin dhjetor. Renie per kete muaj pesoi norma per interesin e huave 6-mujore me 0.58 perqind, krahasuar me nje muaj me pare. Interesi i huave 6-mujore per muajin janar arriti ne 12.32 perqind.



Normat e interesit te Bonove te Thesarit gjate muajit janar 2006, per bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin perkatesisht, 6.78 perqind, 6.47 perqind dhe 5.25 perqind. Edhe gjate ketij muaj ashtu si ne muajin paardhes, e interesit te bonove te thesarti ndoqen nje trend renes, si rezultat i permiresimit te gjendjes se likuiditeteve ne treg, gje qe u reflektua ne uljen e interesave te transaksioneve ne tregun nderbankar dhe ne uljen e yield-it te bonove te thesarit,.

b. Sektori Fiskal

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Janar, jane mbledhur rreth 16.751 miliarde leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 11.190 miliarde leke, qe perfshijne 11.078 miliarde leke ne shpenzime korente dhe 0.112 miliarde leke shpenzime kapitale.

Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e +5.56 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben rreth 7.55% te te ardhurave buxhetore per vitin 2006, ndersa shpenzimet perbejne 4.33% te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 5.40% e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 0.24% e ketij planifikimi.
Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 11.052 miliarde leke (ose rreth 7.60% e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 0.669 miliarde leke (5.96% e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 3.568

miliarde leke (8.92% e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 1.438 miliarde leke (8.70% e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 11.078 miliarde leke, 3.667 miliarde leke (33%) eshte shpenzuar per personelin, 2.205 miliarde leke (20%) per interesat, 0.268 miliarde leke (2%) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 0.058 miliarde leke (1%) per subvencione, 4.186 miliarde leke (38%) per shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore dhe 0.570 miliarde leke (5%) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 0.125 miliarde leke (1%) per shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 5.40% (shpenzime personeli), 7.30% (shpenzime per interesat), 1.26% (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 2.26% (subvencione), 7.08% (sigurimet shoqerore dhe shendetsore), 2.68% dhe 1.08% (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 0.112 miliarde leke nga te cilat 2% financim i brendshem, dhe 98% financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem llogariten per kete periudhe ne rreth 0.01% te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 0.49%.

Suficiti prej 5.561 miliarde leke eshte i barabarte me -15.18% te deficitit buxhetor per 2006.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Janar 2006 ne rreth 16.751 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 15.289 miliardë, grantet 0.024 miliarde dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 1.438 miliardë;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 11.052 miliardë lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 0.669 miliardë lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 3.568 miliarde leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;
Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Janarit:

- TVSH përbënte 5.261 miliardë lekë
- Tatimi mbi fitimin 1.485 miliardë lekë
- Taksa doganore 1.022 miliardë lekë
- Taksat nacionale 0.938 miliardë lekë
- Akcizat 1.626 miliardë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 0 miliardë lekë;

Financimi i Deficitit

Suficiti prej 5.561 miliardë lekë, ne fund te Janarit, ishte 95 përqind me financim të brendshëm dhe 5 përqind me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

c. Sektori i Jashtëm

Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për periudhen Janar - Dhjetor 2005 ishin:

Nje sufiçit i pergjithshem ne bilancin e pergjithshem, prej 151.4 milion dollare, rezultat ky i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 557.3 milion dollare;
- suficit te Llogarise Kapitale, prej 123.8 milion dollare;
- sufiçit te Llogarise Financiare, prej 386.5 milion dollare;
- bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 189.3 milion dollare;



Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 557.3 milion dollare ishin nje:



- bilanc tregtar negativ prej 1,826.9 milion dollare;
- deficit prej 207.1 milion dollare ne bilancin e sherbimeve ;
- suficit prej 178.7 milion dollare ne bilancin e te ardhurave ;
- suficit prej 1,298.2 milion dollare levizjet e transfertave dhe dergesave.

Zërat kryesorë në flukset pozitive në llogarinë kapitale dhe llogarine financiare përfshijnë:

- flukset pozitive të investimeve direkte prej 295.4 milionë dollare;
- flukset negative të investime portofoli prej 6.8 milionë dollare;
- flukset pozitive të kapitaleve të tjera prej 131.0 milionë dollare;

d. Sektori Monetar

Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate muajit Janar 2005, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, ne rreth 80.7 milion dollare krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.



Kjo rritje ka ardhur si pasoje e renijs se e mjetet valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 35.4 milion dollare dhe rritjes se mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise me 116.1 milion dollare.

Ne muajin Janar sistemi bankar rezulton me nje rritje te konsiderueshme prej 98.7 milion dollare ne mjetet valutore neto, krahasuar me nje muaj me pare (dhjetor '05). Kontributin kryesor ne kete rritje e ka dhene rritja e mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 59.9 milion dollare, si dhe rritjes se mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise me 38.8 milion dollare.

Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te muajit Janar 2006 arriti ne 124.7 miliarde leke. Rritja e teprices së kredise, krahasuar me nje vit me pare shenoi vleren 52.6 miliardë leke, me nje rritje prej rreth 73 për qind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjate fillimit te vitit 2006 ka qene ne rritje, duke vazhduar keshtu trendin pozitiv te nisur qe ne vitin 2005.

Nga struktura e teprices se kredise sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valute, duke perbere rreth 74.6 perqind te totalit te treprices se kredise.

Ne ndryshim nga nje muaj me pare, kete muaj u vu re qe pesha spescifike e kredive per individet nuk ndryshoi nga ajo e muajit paraardhes duke qendruar ne nivelin 31.5 perqind.

Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), per muajin janar ka shenur nje rritje prej 0.58 perqind perqind, karahasuar me nje muaj me pare. Kjo oferte kapi shifren rreth 581 miliardë lekë në fund të muajit janar duke shenuar nje rritje te konsiderueshme prej 3.3 miliarde leke kundrejt nivelit te rregjistruar ne muajin dhjetor 2005. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 13 perqind, duke pesuar ulje te ketij ritmi krahasuar me 18.3 perqind qe ishte gjate muajit qershor 2005. Ngadalësimi i ritmit të ofertës monetare është reflektuar kryesisht në preferenca e indiviteve per te investuar ne bono thesari, gje qe ka cuar ne uljen e depozitave ne leke.

Niveli i parase jashte bankave eshte rritur me 9.4 miliarde leke ne krahasim me muajin janar 2005, por duhet theksuar fakti qe eshte ulur me rreth 7.0 miliarde leke krahasuar me muajin dhjetor 2005. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 7 perqind.

Raporte te parase jashte bankave



	Jan ,05	Shku 05	Mars 05	Prill 05	Maj 05	Qer 05	Korr 05	Gush 05	Shtat 05	Tet 05	Nen 05	Dhje 05	Jan ,06
PJB/M3	25.8	25.4	24.8	24.8	24.5	25.1	25.4	25.1	25.0	24.6	24.7	25.9	24.5
PJB/Depozite	34.8	34.0	33.0	33.0	32.5	33.5	34.0	33.5	33.3	32.7	30.2	34.9	32.5

Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, ne fund te muajit janar arriti ne 24.5 perqind duke shenuar nje renie prej 1.36 perqind ne krahasim me muajin dhjetor 2005. Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin janar arriten shifren prej 32.5 perqind duke pesuar nje renie mujore prej 2.44 perqind ne krahasim me muajin dhjetor 2005.

Depozitat ne leke si perberesi kryesor i ofertes monetare, kane pesuar nje rritje te konsiderueshme prej 6.1 miliarde leke ne krahasim me muajin dhjetor 2005. Rritje gjithashtu gjate muajit janar pesuan edhe depozitat ne valute, te cilat ne fund te muajit janar 2006 shenuan nje rritje prej 4.2 miliarde leke ne krahasim me muajin dhjetor 2005. Norma vjetore e rritjes se tyre ne fund te muajit janar arriti ne 27 perqind nga 31 perqind qe ishte ne fund te muajit dhjetor.

Raporti Depozita/M3



	Jan ,05	Shku 05	Mars 05	Prill 05	Maj 05	Qer 05	Korr 05	Gush 05	Shtat 05	Tet 05	Nen 05	Dhje 05	Jan ,06
Dep/M3	74.2	74.6	75.2	75.2	75.5	74.9	74.6	74.9	75.0	75.3	817	74.1	75.5

Rritja e depozitave në valutë gjatë muajit Janar është mbështetur kryesisht në rritja e depozitave te sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 74 për qind të rritjes së depozitave totale në valutë.

Depozitat sipas Burimeve

Gjate muajit janar 2006:

- Sektori i individeve, zuri nivelin me te larte te depozitave pa afat ne leke me rreth 65 perqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 22 perqind dhe nga ndermarrjet jofinanciare publike me 9 perqind.
- Individet dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 76 perqind dhe rreth 18 perqind.
- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96 përqind e totalit)

Kontribiti i sektoreve ne totalin e depozitave Janar 2006



- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 83 përqind) të depozitave totale prej rreth 438 miliardë lekë ne muajin janar 2006. Ata ndiqen nga sektori privat (12 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (3.44 përqind) dhe autoritetet lokale (1.00 përqind). Institucionet financiare kontribuan me rreth 0.70 për qind ne totalin e depozitave.
- Gjatë muajit janar 2006, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit dukshem me 10.4 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave pa afat ne leke (0.4 miliard leke), depozitave monedhe te huaj (4.2 miliard leke) dhe depozitave me afat në lekë (me rreth 5.7 miliardë lekë).

- Depozitat pa afat ne leke te familjareve, pesuan nje rritje te konsiderueshme prej rreth 0.3 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne leke te familjareve pesuan nje rritje, prej rreth 28 miliarde leke.